



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.136, datë 02.06. 2022

PËR

**“FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS  
SË KANDIDATIT QË KA KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, I  
KUALIFIKUAR ME VENDIMIN NR. 125, DATË 26.05.2022,  
TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 159, pika 2 dhe 190, pika 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në pikat 2 deri 7 të nenit 32 dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Rregullores “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pas u njoh me relacionin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit që ka kandiduar për pozicion drejtuesi, kualifikuar me vendimin Nr. 125, datë 26.05.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
  - Arens Çela kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.



4. U shpall në Tiranë, sot më 02.06.2022.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**

**Alfred Balla**

**ANËTAR**

**Sokol Stojani**

**ANËTAR**

**Bujar Sheshi**

**ZV/KRYETAR**

**Tartar Bazaj**

**ANËTAR**

**Nurihan Seiti**

**ANËTAR**

**Eloida Goxhi**

**ANËTAR**

**Esmeralda Keshi**

**ANËTAR**

**Ludovik Dodaj**

**ANËTAR**

**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**

**Mirela Bogdani**